


Amfibët e Shqipërisë

Amfibët janë lloje që përdorin dy mjedise, si tokësore ashtu edhe ujore. Zhvillimi embrional realizohet në ujë dhe larvat marrin frymë me branshi. Pas metamorfozës, amfibët i përshtaten kushteve tokësore dhe fillojnë të marrin frymë me mushkëri.

Format dhe llojet e amfibëve janë të larmishme. Shqipëria, për shkak të pozicionit gjeografik, dhe formave të relievit është mjaft e pasur me amfibë të cilët gjenden kryesisht përgjatë vijës bregdetare, lumenjve, liqeneve, kënetave dhe pellgjeve, si edhe në pyje të ndryshme apo zona me lagështi. Për shkak të lëkurës së tyre të hollë, ata rrezikohen kryesisht nga ndotja.



Amfibët janë shumë të rëndësishëm, pasi janë indikatorë të një mjedisi të pastër.

E bukura e Dheut

Salamandra salamandra, për shkak të bukurisë së saj, ajo ka marrë emërtimin në vendin tonë si “E bukura e Dheut”. Trupi e ka me ngjyrë të zezë dhe me njolla të verdha ose portokalli. Femrat janë pak më të mëdha se sa meshkujt. Preferon habitate, si pyjet me lagështi, pellgje apo lumenj, për tu mbrojtur dhe për të qëndruar e lagësht. Ushqehet kryesisht me insekte, molusqe, etj. Jeton deri në 14 vjet. Është një nga llojet e amfibëve më karizmatikë dhe të dashur për shqiptarët, ku i janë bashkëngjitur tipare dhe legjenda njerëzore për shkak të bukurisë së saj. Për fat të keq, ky lloj kërcënohet nga fragmentimi i habitateve dhe ndotja.

A e dini se kjo lloj salamandre është kryesisht aktive gjatë natës? E gjeni dot arsyen pse?

Përveç salamandrës, në vendin tonë gjenden edhe shumë lloje të tjerë amfibësh me karakteristika shumë të veçanta.

Tritoni i alpeve

Ichthyosaura alpestris është një lloj amfibi që jeton në liqene malore, por mund të gjendet edhe në ultësira, në habitate si përrrenj apo lumenj. Preferojnë edhe pyjet, gjithashtu. Tritoni i alpeve ka ngjyrë të errët, blu, ndërkohë që pjesën e poshtme të trupit e ka ngjyrë portokalli. Ushqimi i tyre përfshin insektet, molusqet, krimbat, etj. Rrezikohet kryesisht nga ndotja kimike e ujërave dhe shkatërrimi i habitateve.

Bretkosa shqiptare


Pelophylax shqipericus është lloj endemik i Shqipërisë dhe gjendet përgjatë vijës bregdetare të vendit. Mashkulli paraqitet me ngjyrë të gjelbër në kafe, me njolla të mëdha, ndërsa femra ka nuanca më të zbehta. Ajo preferon habitate ujore, si liqene, lumenj, kënetat apo pellgje që janë të pasura me bimësi. Kjo bretkosë ushqehet me insekte ujore e tokësore, kërmijn, merimanga, etj.



Disa amfibë të tjerë që gjenden në vendin tonë janë edhe Thithlopa (*Bufo bufo*) dhe Bretkosa e drurëve (*Hyla arborea*).

Të gjithë amfibët e listuar më sipër rrezikohen nga:

- Degradimi i habitateve
- Ndotja
- Ndryshimet klimatike
- Qëllimet tregtare



Bufo bufo © G. Malesa



Hyla arborea © Mihai Baciu

Amfibët janë tejet të rëndësishëm për sa i përket kontrollimit të popullatave të insekteve që rrezikojnë kulturat bujqësore. Po ashtu, ata mbajnë nën kontroll mushkonjat, që përkthehet në përfitim për shëndetin e njerëzve.

Mbrojtja e amfibëve, përveç se është e rëndësishme për mbijetesën e tyre, është po aq me rëndësi edhe për balancimin e ekosistemeve dhe biodiversitetit në tërësi.

Kontribuo edhe ti në ruajtjen e amfibëve dhe habitateve të tyre në Shqipëri.


Skano këtu dhe plotëso formatin e aplikimit!



In partnership with



Supported by



AMFIBËT E SHQIPËRISË

E bukura e dheut, Tritoni i Alpeve dhe Bretkosa Shqiptare



Albania is Biodiversity